



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 111/01-29575 /2019
Kaçanik, 06.09.2019

Në bazë të nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, lidhur me pranimin e praktikantëve në QEAP "Agimi" në Kaçanik, si praktikantë (me pagesë) në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpall këtë:

KONKURS PËR PRAKTIKANTË

Nr.	INSTITUCIONI QEAP „Agimi“	Numri i Praktikantëve
1	Motër Edukatore	2
2	Edukatore	2
3	Ndihmës Kuzhinierë	1
	Gjithsej:	5

- Pagesa për një muaj do të jetë: 150 € (euro).

Detyrat kryesore për motër edukatore:

- Kujdes fizik dhe emocional ndaj fëmijëve;
- Raportimi i çfarëdo shqetësimi për zhvillimin apo shëndetin e cilitdo fëmijë /individualisht/ drejtorit të IP;
- Ndërtimi i raporteve dhe komunikimit profesional miqësor dhe bashkëpunues me prindër, kolegë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm;
- Të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara nga drejtori i IP -së.

Detyrat kryesore për edukatore:

- Mbajtja e komunikimit të hapur me prindërit dhe ofrimi i informatave korrekte lidhur me mbarëvajtjen e fëmijës;
- Organizimi i materialeve dhe pajisjeve të përdorura sipas metodologjisë të përcaktuar të IP-së;
- Përdorimi i aktiviteteve të ndryshme sikur (këndimi, rrëfimi, lojërat e strukturuar, arti, aktivitetet jashtëshkollore) për stimulimin dhe rritjen e aftësive të fëmijëve;
- Bashkëpunim i ngushtë me stafin e IP-së;
- Të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara nga drejtori i IP -së.

Detyrat kryesore për ndihmës kuzhinier:

- Përkujdeset për mirëmbajtjen/përkujdesjen për pajisjet e kuzhinës dhe ambientit të brendshëm të IP-së;
- Shpërndarjen e ushqimit për fëmijët e institucionit parashkollor;
- Kryen edhe punë tjera të cilat i cakton drejtori i IP-së.

Dokumentet e nevojshme për aplikim për motër edukatore dhe edukatore:

- Certifikata e notave dhe vërtetimin e regjistrimit të semestrit;
- CV- në;
- Letër motivuese;
- Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës (kopje).

Dokumentet e nevojshme për aplikim për ndihmës kuzhinier

- diplomën e shkollës së mesme, certifikata për aftësitë profesionale;
- CV- në;
- Letër motivuese;
- Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës (kopje).

Të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët e drejtimeve përkatëse.

Afati dhe mënyra aplikimit.

Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-**Zyra e Pranimit**, kati përddes.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 06.09.2019 deri 13.09.2019.

Drejtori i drejtorisë
z. Zahir Doda

